



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 16-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 30. 04. 2015 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese
2. Labinot Shahini, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Daut Azemi, anëtar
5. Agron Hajdini, anëtar
6. Arton Retkoceri, anëtar
7. Naim Jahiri, anëtar
8. Burbuqe Fazliu, anëtar
9. Linda Shahini, anëtar
10. Xhevat Olluri, anëtar
11. Rizah Bajraktari, anëtar
12. Ukë Kryeziu, anëtar
13. Merita Zeqiri-Hajrizi, anëtar
14. Hajrije Salihu, anëtar
15. Blerim Gashi, anëtar
16. Adelina Krasniqi, anëtar
17. Florent Hoxha, anëtar
18. Petrit Kelmendi, anëtar
19. Ragip Zejnullahu, anëtar
20. Nazmi Krasniqi, anëtar
21. Enver Kozhani, anëtar
22. Feriz Hasani, anëtar
23. Ali Stublla, anëtar
24. Valbona Shillova, anëtar
25. Burbuqe Ilazi, anëtar
26. Vlora Buja, anëtar
27. Arben Bahtiri, anëtar
28. Edita Gashi, anëtar
29. Ramiz Qeriqi, anëtar
30. Zoran Çirkovic, anëtar
31. Xhavid Maholli, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Shkelzen Hajdini, Drejtor i DBF-së
2. Rasim Hasani, Drejtor i arsimit
3. Basri Hashani, Drejtor i DKRS
4. Avdullah Fazliu, Drejtor i Shëndetësisë
5. Ilir Tasholli, Drejtor i Urbanizmit
6. Fauz Xhemajli, Drejtor i Administratës
7. Latif Ramadani, Drejtor i DEZH
8. Vlora Krasniqi, zyra ligjore
9. Kimete Jashanica, përfaqësuese e OSBE-së
10. Përfaqësuesit e KFOR-it Turk,
11. Bekim Krasniqi, "YAHK"
12. Bukurije Zejnullahu, zyrtare për informim
13. Përfaqësuesit e mediave
14. Naser Bytyqi-përkthyes, shqip-serbisht
15. Rifat Hoxha-perkthyes, shqip-serbisht

Proqesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Sami Murati**.

Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë 30 anëtarë nga gjithsej 31 dhe se ekziston kuorumi për punë dhe vendosje të plotëfuqishme hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës e keni marrë, a ka dikush vërejtje apo plotësime.

Edita Gashi, kërkoj që të hynë në rend të ditës ndërrimi i anëtarit të KPF-së meqë kërkesën e kam dorëzuar më herët.

Vlora Limani-Hajnuni, lidhur me këtë qështje përgjigjjen e keni marrë gjatë bisedës që kemi pasur me juve dhe ju preferoj për këtë qështje t'i ndiqni procedurat ligjore.

Florent Hoxha, na si grup parlamentar i PDK-së e përkrahim kërkesën e përfaqësuesës së Vetëvendosjes që kërkesa e saj të hynë në rend dite për shqyrtim

Me që diskutimetjera nuk pati rreth rendit të ditës Kryesuesja e Kuvendit, vuri në votim rendin e ditës dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 18 votave për 12 kundër për punën e kësaj mbledhje aprovoi këtë :

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 15-të e KK-së
2. Raporti i Buxhetit të Alokuar dhe Shpenzimi në Bazë të Burimit të Mjeteve të Kategorive Ekonomike dhe Programeve për Tremujorin e vitit 2015 Për Komunën e Lipjanit.
3. Propozim Rregullorë për Taksat Komunale.
4. Propozim Rregullorë për Ndarjen e Subvencioneve nga Buxheti i Komunës
5. Propozim Rregullorë për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullorës për Bashkëpunimin e Komunës dhe Organizimin e Fshatrave, Vendbanimeve dhe Lagjeve Urbane.
6. Propozim Vendimi për Organizimin e Zgjedhjeve për Zgjedhjen e Këshillave dhe Kryetarëve të Këshillave të Lokalitetit.

Në vazhdim Kryesuesja pyeti anëtarët se a ka dikush të thotë diqka para se të kalojmë në punë sipas rendit të ditës së aprovuar?

Linda Shahini, kërkoj që Komuna në kuadër të mundësive të merr masa për pastrimin e objekteve të Minjerës së Magnezitit në Magurë meqë këto objekte janë shëndrru në deponi dhe paraqesin rrezik për shëndetin e qytetarëve. Unë e di se kjo qështje nuk i takon Komunës por mundësisht kërkoj që të intervenohet për këtë qështje.

Ali Stublla, kam pyetje për shkollën në Banullë meqë kam bërë kërkesë që 1 muaj për pranimin teknik të kësaj shkolle dhe pyes pse nuk po bëhet pranimi teknik. Pastaj kërkoj kyqjen në rrjetin elektrik të objektit të gjimnazit në Lipjan meqë kërkesa është bërë që 1 vit e gjysmë.

Vlora Limani-Hajnuni, ju jeni kompani që po i arsyetoni punët por duhet të keni kujdes në Kuvend për konflikt interesi dhe përgjigjen do ta merrni nga Drejtori i arsimit.

Florent Hoxha, unë po i ngriti disa shqetësime për qytetarët e Gadimes të cilët janë mirënjohës për ndërtimin e urës e cila lidh edhe Gadimen e Epër por ata kërkojnë që në kuadër të mundësive të ngritet edhe një urë lidhëse për kombësor nga ana e Tashollëve me Shpellen.

Shqetësim tjetër është i qytetarëve Leletiq për ujërat e zeza të cilat dalin mbi sipërfaqen tokësore dhe kërkojnë sanimin e kësaj gjendje deri në realizimin e projektit të kanalizimit.

Në fshatin Mirenë thuhet se shkolla punon në 3 ndrrime dhe pyes se a është kjo e vërtetë.

Te ndërtimi i rrugës 4 korsi në hyrje të qytetit të Lipjanit ujërat e zeza kanë dalë mbi sipërfaqe të tokës andaj kërkojmë që edhe kjo të rregullohet.

Problem tjetër kemi me ujësjellësin në Shalë ku një përsos nga burimi ku merret uji edhe pse nuk është pronë e tij po pengon marrjen e ujit andaj kërkoj që të mirren masa.

Enver Kozhani, po e ngris shqetësimin e shumicës së lokaliteteve në Komunën e Lipjanit për shkak të krijimit të deponive të egra e që është mjaft shqetësuese gjendja faktike e tyre e cila është e pa kontrolluar nga askush dhe krijon rreziqe për shëndetin e qytetarëve si dhe të kafshëve shtepiake ku kemi rast që qytetarëve u kanë ngordhur kafshët për shkak të helmimit në këto deponi.

Pastaj tha se ekziston rreziku edhe i shfaqjes së ndonjë epidemie e cila ka koston e vetë, andaj kërkojmë nga zyrtari për mbrojtje të mjedisit që të na jap një informatë për gjendjen aktuale në territorin e Komunës së Lipjanit. Gjithashtu bëri pyetje pse nuk po rrenohet objekti i vjetër në Kraishtë.

Hajrije Salihu, kërkoj nga Drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport që të funksionalizohet shtëpia e atë Shtjefën Gjeqovit.

Shqetësim tjetër kam lidhur me organizimin e ditës përkujtimore i cili organizim ka qenë në nivel dhe ka pas mjaftë prezent në sallë por e ni obligim moral që të paraqes këtu meqë kam pasur disa telefonata lidhur me shpalljen e filmit dokumentar në sallë i cili ka kaluar disa limite ku një pjesë e familjarëve që kanë qenë prezent nga dhimbja e kanë lëshuar sallën, andaj kërkoj që në të ardhmen ky film të ruhet si dokument por shpallja e tij të bëhet në një formë më të butë në mënyrë që mos t'i prek familjarët.

Valbona Shillova, përmendi shqetësimin e qytetarëve të fshatit Topliqan për shkak të deponisë së krijuar afër fushës së sportit për të cilën kërkoj që të pastrohet – hiqet kjo deponi.

Blerim Gashi, pyetjet që i kam bërë më herët nuk kam marrë përgjigje dhe dihet se na jemi këtu përfaqësues të qytetarëve dhe kemi obligim që të paraqesim shqetësimet dhe kërkesat e qytetarëve.

Rasim Hasani, Drejtor i DKA-së, tha se për shkollën në Banullë është mirë që ka përfunduar ndërtimi dhe është formuar Komisioni për pranim teknik por duhet ta dini se këtu janë disa procedura dhe duhet pritur procedurat.

Sa i përket Gjimnazit na e kemi bërë kyqjen e kanalizimit kurse për kyqje në rrjetin elektrik i kemi bërë kërkesë KED-sit.

Sa i përket shkollës në Mirenë po themi se shihet se gjendja e objektit nuk është e mirë në atë shkollë dhe duhet të ndërtohet një shkollë e re.

Në Kraishtë nuk ka përfunduar shkolla e re dhe nuk mund të rrënohet ajo pa përfunduar e reja.

Ilir Tasholli, Drejtor i DPU-së tha se sa u përket deponive të egra që përmendi Enveri ju njoftoj se në vitin e kaluar me buxhet kemi planifikuar 50 mijë euro e gjithashtu nga organet është konstatu se në territorin e Komunës së Lipjanit janë 110 deponi të egra dhe kemi shpall konkurs për pastrimin e këtyre deponive mirëpo nuk ka konkuru asnjë kompani e licencuar.

Sa i përket urës në Gadime kam pranuar kërkesën e qytetarëve dhe në kuadër të mundësive do ta ndërtojmë.

Çështja e legalizimit të objekteve është mjaft konfuze meqë janë përfshi edhe vendet rurale dhe për shtepitë e ndërtuara para 50 viteve duhet të paraqitet kërkesa për legalizim dhe të paguhet taksë prej 500 euro dhe qështje e legalizimit të objekteve do të vazhdohet në 3 faza. Na deri me 11 qershor kur edhe është afati i fundit do ta hartojmë regjistrin e ndertimeve pa leje.

Basri Hashani, Drejtor i DKRS-së, tha se unë e kuptoj shqetësimin e profesoreshës Hajrije për atë shtepinë e Shtjefën Gjeqovit dhe këtu kemi pasur një kontest me Ministrinë e Kulturës dhe kemi parashtrur kërkesë Ministrisë për rregullimin e kësaj shtëpie e besoj se së shpejti do të rregullohet.

Sa i përket shpalljes së filmit dokumentarë në ditën përkujtimore të martirëve dhe Dëshmorëve kjo ka qenë kërkesë e këshillave organizative të fshatrave.

Florent Hoxha, dita e Dëshmorëve është 14 qershori, andaj dihet edhe dita e martirëve kur është dhe nuk është mirë me i përzi këto.

Blerim Gashi, unë nuk jam i kënaqur me përgjigjjen e Drejtorit të Urbanizmit me që unë i di zyret e drejtorëve dhe mund të shkoj aty por përgjigjjet duhet të ipen këtu në Kuvend.

Merita Zeqiri nuk pajtohet me përgjigjjen e Drejtorit të kulturës dhe duhet të ndahet dita e Dëshmorëve dhe dita e martirëve.

Me që pyetje të tjera nuk pati u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 15-të e KK-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja, Vlora Limani-Hajnuni pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 15-të të Kuvendit?

Me që askush nuk u lajmërua për fjalë, Kryesuesja vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me shumicën e votave

Aprovoi

Ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 13-të të Kuvendit pa vërejtje

Shtesë: Ekstrakti.

Raporti i Buxhetit të Alokuar dhe Shpenzimi në Bazë të Burimit të Mjeteve të Kategorive Ekonomike dhe Programeve për Tremujorin e vitit 2015 për Komunën e Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Shkelzen Hajdini Drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti i cili është pjesë përbërëse i këtij procesverballi.

Agron Hajdini, ky është raport për 3 mujorin e parë të vitit 2015 dhe të gjithë e dijmë dhe duhet të pajtohemi se investimet kapitale në këtë periudhë bëjnë zvogëlimin e shpenzimeve meqë në këtë 3 mujor nuk ka investime në projekte.

Te të hyrat vetanake për të cilat u tha se ka ramje në këtë periudhë unë besoj se këtu ka pasur ndikim migrimi i popullatës, por konsideroj se deri në fund të vit të hyrat vetanake do të realizohet sipas planifikimit.

Petrit Kelmendi, kur e analizojmë buxhetin e vitit **2015** shihet se ky buxhet për këtë periudhë është realizu vetëm 46%. Ky raport është paraqitë në vijat e trasha dhe është mirë që shpenzimet të paraqiten me planin kontabël se ne si asambleistë nuk e dijmë se si janë bërë shpenzimet për qdo kategori.

Blerim Gashi, na të gjithë e dijmë se në 3 mujorin e parë shpenzimi është më i vogël e gjithashtu edhe realizimi i të hyrave. Unë besoj se planifikimi i buxhetit do të realizohet deri në fund të vitit. Vendimi i Qeverisë për faljen e borxheve, konsideroj se është pozitive mirëpo pyes Drejtorin se në cilën fazë është ky Vendim.

Te mallrat dhe shërbimet shpenzimi është vetëm 13% dhe me këtë shpenzim a ka mbet dikush keq nga Drejtoratet meqë është shpenzim i vogël dhe deri në fund sipas kësaj del se te kjo kategori shpenzimi do të jetë vetë 60%.

Shelzen Hajdini, u kërkoi që të paraqitet shpenzimi për qdo kategori por nëse bëhet kjo atëherë duhet të bëhet një libër e që besoj se edhe ju rëndoheni me këtë. Blerimi pyeti për Vendimin e qeverisë për faljen e borxheve dhe e dijmë se këto janë borxhe të këqije dhe si të kalojnë 7 vjet ma nuk mundemi me e nxjerr atë borxh.

Te shpenzimet kemi disa të hyra të bartura dhe askush nuk ka mbetë keq. Në fund tha se krejt qka kemi obligime i kemi përmbushë.

Petrit Kelmendi, unë i kam 2 tabela para veti është bërë një analizë sipas planit kontabël në vitin 2013 dhe sipas këtij plani kontabël mund të paraqiten shpenzimet e derivateve të naftës si dhe udhëtimet mbrenda dhe jasht vendit.

Nazmi Krasniqi, sipas raportit shihet se shpenzimet kanë qenë të vogla mirëpo na që nuk jemi ekonomista vështirë që mund t'i kuptojmë këto. Sa i përket Vendimi për falje të borxheve kjo është mirë por pyes se cili qytetarë do t'i paguaj borxhet prej 2008 në mënyrë që t'i falen borxhet e mëherëshme. Në vazhdim pyeti se sa shpenzime janë bërë në ekskurzionin për arsimtarë në Shqipëri.

Florent Hoxha, na si asambleistë kemi obligim ligjor që të kërkojmë se si janë bërë shpenzimet e buxhetit dhe mendoj se shpenzimi për këtë 3 mujor me 44% nuk është mirë. Krahasset që bëri Drejtori me komunat tjera kjo nuk duhet me u bërë. Drejtori foli edhe për ndalesat që ka bërë thesari dhe këtu dihet se këto ndalesa bëhen për shkak se janë kryer punët. Sa i përket të hyrave vetanake është mirë me ju referu të dhënave që i kemi paraqitë.

Shkelzen Hajdini, ne jemi duke raportu për një menagjim të mirë financiar dhe në kohën kur keni qenë ju Florent nuk ka pasur menagjim të mirë dhe ju e dini se në atë kohë janë lidhur kontratat pa pasur mjete e sot asnjë kontratë nuk guxon me u lidh pa u zotuar mjetet.

Feriz Hasani, kam dëgju se dje në Komunën tonë ka qenë Kryeministri dhe disa Ministra dhe më intereson të di se qka ka premtu për Komunën tonë.

Shkelzen Hajdini, po është e vërtetë se ka qenë Kryeministri dhe disa Ministra dhe diskutimi ka qenë më shumë i fokusum për Lumin "Sitnica" dhe rrugën për aeroport.

Me që diskutime të tjera nuk pati rreth kësaj pike, Kryesuesja, vuri në votim raportin dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 18 për 10 kundër 1 apstenim

Aprovoi

Rraportn e Buxhetit të Alokuar dhe Shpenzimi në Bazë të Burimit të Mjeteve të Kategorive Ekonomike dhe Programeve për Tremujorin e vitit 2015 Për Komunën e Lipjanit

Shtesë : Raporti

Pas përfundimit të kësaj pike në ora 12,10 u dha pauzë deri në ora 13,15.

Pas pauzës në ora 13,20 Kuvendi vazhdoi punën sipas pikës së tretë.

III

Propozim Rregullorre për Taksat Komunale

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Drejtorit të administratës Fauz Xhemajlit i cili njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Rregullorja.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Agron Hajdini, këtë Rregullore e kemi shqyrtu edhe në KPF dhe i kemi parë ndryshimet që janë bërë nga Rregullorja e mëparshme dhe ne e përkrahim këtë propozim Rregullore. E kemi pas të pakjartë taksën vjetore në shumë prej 100 euro për vendosjen e antenave për telefoni mobile dhe internet por këtë e arsyetoi Drejtori.

Enver Kozhani, këtë Rregullore ne si grup parlamentar i PDK-së e kemi shqyrtu dhe kemi vërejtjet tona si vijon:

Në nenin 6 në numrin 7 ku taksa për aktin e vdekjes në shumë prej 5 euro propozojmë që të hiqet kjo taksë.

Ne nenin 6 nr. 5 korigjimi i shënimeve të gjendjes civile propozojmë që taksa prej 3 euro të zbritet në 1 euro për shkak se këto korigjime bëhen në iniciativën e palës të lëshuar nga zyrtarët komunal atëherë pse mos të jetë kjo taksë 1 euro.

Te neni 11 taksa për shfrytëzimin e përkohshëm të objekteve për Rini, sport dhe kulturë e paraparë për 10 euro për 1 orë të lirohen ekipet e formuara nga kategoritë e dalura nga lufta e fundit ku dihet se këto kategori kanë dhënë mjaft kontribut për neve.

Te neni 13 nuk e kemi të kuartë taksën për antenat të telefonisë mobile dhe të internetit në shumën e cekur prej 100 euro si dhe vendosja e antenave të internetit në shumën prej 30 euro në baza vjetore dhe pyes se a duhet ta paguajn personat fizik apo kompanit e telefonave mobil dhe interneteve dhe për këtë kërkoj sqarim.

Ne si grup parlamentar edhe në vitin e kaluar kemi tërhequr vërejtjen për termin që është propozuar prap në këtë Rregullore të zhdukurit e UÇK-së dhe kërkojmë që të hjeket kjo dhe plotësohet me termin të zhdukurit gjatë luftës së UÇK-së. Në fund tha se ne si grup parlamentar i PDK-së propozojmë për taksat administrative komunale të liruar sipas Ligjit të dalura nga lufta e fundit si pjesë e lirimit nga taksat administrative të jenë edhe veteranët e UÇK-së.

Xhevat Olluri, edhe vjet e kemi shqyrtu këtë Rregullore dhe këtë që e kërkoj Enveri ndryshimin e termit të zhdukurit e UÇK-së dhe juristi e ka arsyetu se me Ligj është përcaktu

termi të zhdukurit e UÇK-së dhe kjo është keq dhe nuk e di se sa na kemi mundësi me e ndryshu.

Arben Bahtiri, e përkrahu parafolësin që organizatat e dalura nga lufta të lirohen nga pagesa e shfrytëzimit të sallave ndërsa për organizata dhe klube tjera qmimi për shfrytëzimin e sallave të caktohet 25 euro.

Edita Gashi, te neni 3 ku thuhet se këto taksa të caktojnë ministrinë me udhëzime administrative, andaj kërkoj që kësaj Rregullore t'i bashkangjiten udhëzimet administrative në mënyrë që qytetarët të kenë ma të kjashtë si; shembull po e marr te shëndetësia se për heqjen e 1 dhëmbi sa paguhet taksa.

Nazmi Krasniqi, është mirë që Drejtori të na shpjegoj se kjo Rregullore për taksa sa ka gjetë zbatim te popullata.

Vlora Limani-Hajnuni, para se me ja dhënë fjalën Drejtorit ju kisha lutë që kur jepni propozim për ndryshim të një takse atëherë duhet të bazoheni në Ligj apo udhëzime administrative se në bazë të cilit nen duhet të ndryshohet ajo që propozoni e jo propozimet të jenë fontanë dëshirash pa pasur mbështetje ligjore.

Fauz Xhemajli, qështja e taksës për akt vdekje që u kërkua me u zbritë këtë e kemi shqyrtu edhe në KPF dhe kjo ka të bëjë me aktë vdekjen për trashëgimi të pasurisë dhe për këtë bëhet Aktëvendimi dhe nuk është taksa e lartë. U tha për zbritjen e taksës për korigjim në librat amzë këto bëhen për shkak se qytetarët vetë kur i regjistrojnë bëjnë gabim meqë kërkojnë që emërtimi të bëhet siqë ata thojnë si shembull po e marr unë e kam mbiemërin Xhemajli a dua ta kthej Xhemajli dhe për këtë duhet të paguhet taksa. Sa i përket vendosjes së antenave këtë pagesë e bëjnë ata që ushtrojnë veprimtarinë e internetit dhe telefonave mobil. Arbeni e përmendi që për shfrytëzimin e sallave sportive të rritet taksa por unë mendoj se taksa e parapar prej 10 euro është e mjaftueshme.

Enver Kozhani, për shumicën e vrëjtjeve e dha arsyetimin Drejtori dhe për disa prej tyre nuk pajtohem si shembull për përmirësimin e emërit apo mbiemrit ku është parapar taksa, konsideroj se pala nuk është fajtor por fajtor janë punëtorët e administratës se dihet në të kaluarën kanë punuar edhe punëtor të nacionaliteteve tjera të cilët regjistrimet i kanë bërë gabimisht andaj kërkoj që për këto përmirësime të lirohen nga taksa.

Ramiz Qeriqi, për aktin e vdekjes mendoj se duhet të hiqet taksa. Për fjalën të zhdukurit e UÇK-së. Unë nuk e di se si Kuvend a kemi të drejtë me kërkua nga organet e nivelit qëndrorë të përmirësohet në Ligj dhe të thuhet: të zhdukurit gjatë lurtës së UÇK-së.

Blerim Gashi, propozoj që tarifat të mbesin ashtu siqë janë propozu meqë na nuk mund të ndryshojmë asnjë nga ajo që është parapa me Ligj a dihet se qështja e ligjeve është e nivelit qëndror.

Latif Ramadani, Drejtor i DEZH, dashta me u ndal te fjalja ku thuhet të zhdukurve të UÇK-se dhe këtë e kemi pasur edhe në vitin e kaluar dhe ashtu siqë është në Ligj e kemi parapa në Rregullore dhe nuk mund ta ndryshojmë Ligjin dhe të drejtat e të zhdukurve të UÇK-së.

Florent Hoxha, nëse na nuk kemi bërë harmonizimin e Rregullores me ligjet e parapara, atëherë niveli qëndror do ta kthej në arsyetimin se në bazë të cilave ligje kemi gabuar dhe nuk e licencon këtë Rregullore.

Hajrije Salihu, në Rregullore është thënë akt vdekje dhe nuk duhet të thuhet akt vdekje por të thuhet vërtetim për aktin e vdekjes. Gjithashtu në këtë Rregullore ka gabime gjuhësore dhe kërkoj që të përmirësohen këto gabime.

Nazmi Krasniqi, disa propozime që ipen nga anëtarët për ndryshim duhet të vëhen në votim e jo pa votim të refuzohen.

Fauz Xhemajli, ne ndoshta nuk mund të pajtohem për disa terminologji por na nuk mund t'i ndryshojmë ato që i ka pru niveli qëndror.

Vlora Limani-Hajnuni, nëse ju doni që ta ndryshojmë pikën 3 të nenit 8 dhe të thuhet të zhdukurit gjatë luftës së UÇK-së na e ndryshojmë por nuk e di se a do ta pranoj niveli qëndror.

Xhevat Olluri, unë e propozova këtë fjali që po e thoni ju Kryesuese por tani jam kundër se nuk kemi sqarim nga Ministria për këtë Ligj.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike Kryesuesja vuri në votim propozimin e Rregullores për taksat komunale dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 18 vota për 12 kundër aprovoi këtë:

Rregullore Për Taksat Komunale

Shtesë: Propozim Rregullorja

IV

Propozim Rregullore për Ndarjen e Subvencioneve nga Buxheti i Komunës

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Basri Hashanit Drejtor për KRS i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Rregullores.

Pastaj tha se kjo Rregullore ka qenë edhe në diskutim publik.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Nehat Terpeza, na si grup parlamentar i LDK-së e kemi shqyrtu këtë Rregullore dhe i japim mbështetje meqë kjo Rregullore parasheh procedurat dhe kriteret për ndarje të subvencioneve.

Florent Hoxha, na kemi thënë edhe më heret që subvencionet ndahen me Rregullore e cila përcakton kriteret se kujt mund t'i ipen subvencionet.

Te zyra e Kryetarit subvencionet kanë qenë deri në 1500 euro kurse tani kjo shumë është rrit në 2000 euro dhe na nuk do ta përkrahim këtë rritje. Për organizata jo qeveritare të cilat subvencionohen kërkoj që këtu të përfshihet edhe organizatat e dalura nga lufta e UÇK-së.

Basri Hashani në Rregullore nuk kanë qenë të përfshira disa qështje si shembull po e marr për fatëkeqësi elementare dhe kjo është në interes të qytetarëve.

Me që diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike, Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni vuri në votim propozimin e Rregullores për taksat komunale dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 18 vota për 9 kundër miratoi këtë:

Rregullore për Ndarjen e Subvencioneve nga Buxheti i Komunës

Shtesë: propozim Rregullorja

V

Propozim Rregullore për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullorës për Bashkëpunimin e Komunës dhe Organizimin e Fshatrave, Vendbanimeve dhe Lagjeve Urbane

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Fauz Xhemajlit Drejtor i DA, i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Rregullore e cila është pjesë përbërse e këtij procesverbali.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Nazmi Krasniqi, kjo Rregullore ka mangësitë zgjedhore dhe ne kërkojmë që këto zgjedhje për këshillat e fshatrave të mbahen sipas ligjit zgjedhor.

Daut Azemi, në takimin që kemi pasë me shefat e grupeve parlamentare ka prezentuar edhe Nazi në atë takim dhe është pajtuar plotësisht me këtë Rregullore kurse sot po e kundërshton këtë Rregullore.

Xhevat Olluri, ne grupi parlamentar i AAK-së e përkrahim ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për bashkëpunimin e Komunës dhe organizimin e fshatrave vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës.

Adelina Krasniqi, grupi parlamentar i AKR-së e përkrahim këtë ndryshim të Rregullores me që këtë e ka kërkuar edhe DEMOS-i.

Feriz Hasani, unë konsideroj se kjo formë e parapar e zgjedhjeve me këtë Rregullore nuk është demokratike e konsideroj se me 20 vota në një fshat nuk mund të zgjidhet Kryetari i fshatit dhe pyes se si do ta ndien vetin ai Kryetar kur zgjedhet me kaq vota.

Vlora Limani-Hajnuni, kjo Rregullore ka qenë e miratuar e gjithashtu forma e zgjedhjes së Kryetarit të këshillit të fshatit nuk ka ndryshuar. Ne Rregulloren e mëhershme kanë qenë zgjedhje të nivelit të tretë qka është në kundërshtim me Kushtetutë meqë Kushtetuta nuk parasheh zgjedhje të nivelit të tretë. Në vazhdim arsyetoi tri ndryshimet që janë bërë në Rregullore dhe për të cilat ndryshime jemi pajtu me shefat e grupeve parlamentare.

Xhavit Maholli, kam vërejtje te neni 2 paragrafi 8 dhe kërkoj që të thuhet a po shtohet fjala me të drejtë vote.

Enver Kozhani, na si subjekt i PDK-së nuk jemi kundër zgjedhjes së këshillave të fshatrave dhe propozoj që në zgjedhje të shkohet me vota e jo siqë po pretendohet që këto zgjedhje të mbahen nëpër oda e që dihet se gjinia femërore nuk shkojnë nëpër oda dhe me këtë rast shkelet barazia gjinore.

Fauz Xhemajli, me Rregullore është e precizueme mosha se kush mund të votoj.

Me që diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike, Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni vuri në votim propozimin e Rregullores për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullorës për Bashkëpunimin e Komunës dhe Organizimin e Fshatrave, Vendbanimeve dhe Lagjeve Urbane dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 17 vota për 10 kundër miratoi këtë:

Rregullore

Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullorës për Bashkëpunimin e Komunës dhe Organizimin e Fshatrave, Vendbanimeve dhe Lagjeve Urbane

Shtesë: Rregullorja

VI

Propozim Vendimi për Organizimin e Zgjedhjeve për Zgjedhjen e Këshillave dhe Kryetarëve të Këshillave të Lokalitetit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Fauz Xhemajlit Drejtor i DA, i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Me që diskutime nuk pati rreth kësaj pike, Kryesuesja, vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me shumicën absolute të votave miratoi këtë:

VENDIM
PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLAVE DHE
KRYETARËVE TË KËSHILLAVE TË LOKALITETIT

Neni 1

Me këtë Vendim përcaktohet që Organizimi i zgjedhjeve për zgjedhjen e këshillave dhe kryetarëve të këshillave të lokalitetit në territorin e Komunës së Lipjanit të fillojë në muajin maj të këtij viti.

Neni 2

Numri i anëtarëve të këshillave në pajtim me Rregulloren do të jetë në bazë të numrit të banorëve si vijon:

Për lokalitetet deri në 1000 banorë do të ketë 5 anëtarë
Për lokalitetet deri në 3000 banorë do të ketë 7 anëtarë
Për lokalitetet deri në 5000 banorë do të ketë 9 anëtarë
Për lokalitetet mbi 5000 banorë do të ketë 11 anëtarë

Neni 3

Komisioni për organizimin e zgjedhjeve në vendbanime, fshatra dhe lagje urbane do të kryej të gjitha detyrat, përkritazi me organizimin e zgjedhjeve për zgjedhjen e këshillave dhe kryetarëve të këshillave të lokalitetit në pajtim me dispozitat e Rregullores për Bashkëpunimin e Komunës dhe Organizimin e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane Nr. 15-011-45599 të datës 12.11.2014.

Neni 4

Për mënyrën e sigurimit të mjeteve të nevojshme financiare për organizimin e zgjedhjeve të cekura do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe HSIK-DEMOS.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe publikimit në Webfaqen e Komunës .

Pasi çështje të tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 15,⁰⁰

Ekstraktin e hartoi
Sami Murati

Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani-Hajnuni